



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 281/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e **Minir Jaha** me vendbanim në **Gjermani**, për shkak të refuzimit të aplikacionit për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.08.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet i bazuar apeli i ushtruar nga **Minir Jaha** me vendbanim në **Gjermani**, i paraqitur kundër KQZ-se për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, dhe **Urdhërohet** KQZ-ja, të përfshijë apeluesin në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës,

A r s y e t i m

Më 23.08.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga **Minir Jaha** kundër KQZ-së për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahën me datën 17 tetor 2021, me te cilin i është refuzuar aplikacioni i tij që të përfshihet në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës.

Paneli pasi që shqyrtoi apelin konstatoi:

Apeli është i bazuar

Paneli, konstatoi se provat e bashkangjitura nga parashtruesi i apelit janë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar se i njëjti në kuptim të nenit 5.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme/Lokale (LZP), i plotëson kushtet për tu regjistruar në Listën e Votuesve Jashtë Kosovës, prandaj në bazë të nenit 118.1 të LZP-së lidhur me nenin 10.7 të Rregullës Zgjedhore nr. 2/2015, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 281/2021 më datën 25.08.2021.



Kryesues i Panelit
Zyhdi Haziri

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, në afat prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.